

VENDIM
Nr. 176, datë 26.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMIT
TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR NDËRMJET
SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA DHE “ALBPETROL” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 35 dhe 36, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a dhe “Albpetrol” sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ushtron aktivitetin si operator i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri, në zbatim të VKM-së nr. 848, datë 7.12 2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe “Albgaz” sh.a.”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, ka miratuar certifikimin paraprak të shoqërisë “Albgaz” sh.a në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror dhe me vendimin nr. 90, datë 7.6.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për periudhën 5.1.2017 – 20.9.2017”, ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 127, datë 16.8.2017, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- ERE ka marrë dijeni për draftimin e kësaj kontrate me shkresën e “Albgaz” sh.a nr. 23 prot., datë 3.4.2017.

Me shkresën nr. 107 prot., datë 9.10.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a i është drejtuar ERE-s për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes midis “Albpetrol” sh.a dhe “Albgaz” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a dhe “Albpetrol” sh.a.

2. Drejtoria e e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti